


Tregtia e jashtme e mallrave

Prill, 2019

Tiranë, më 17 Maj 2019: Në Prill 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u ulur me 0,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 4,1 %, në krahasim me Mars 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 57 mld lekë, duke u rritur me 8,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 1,6 %, në krahasim me Mars 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 30 mld lekë, duke u rritur me 17,4 %, krahasuar me Prill 2018 dhe me 7,3 %, në krahasim me Mars 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në katërmujorin e parë të vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 99 mld lekë, duke u ulur me 2,3 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 205 mld lekë, duke u rritur me 3,2 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 106 mld lekë, duke u rritur me 8,9 %, krahasuar me 2018.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Ulja vjetore e eksporteve prej 0,2 %, këtë muaj është ndikuar nga grupi: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -8,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +2,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,0 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,9 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Prill 2019



Eksportet, gjatë këtij katërmujori janë ulur me 2,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,8 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 8,4%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,2 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbim” me +2,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me -1,3 pikë përqindje, etj.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Prill 2019



Si katërmujor, importet janë rritur me 3,2 %, krahasuar me katërmujorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,0 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,4 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Prill 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Prill 2018 janë: Kosova (70,4 %), Spanja (8,7 %) dhe Gjermania (7,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-5,7 %), SHBA (-6,7 %) dhe Zvicra (-96,9 %).

Gjatë këtij katërmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (52,0 %), Maqedonia e Veriut (20,1 %) dhe Turqia (79,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-1,1 %), Spanja (-25,3 %) dhe Gjermania (-3,3 %).

Në muajin Prill 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Prill 2018 janë: Turqia (19,4 %), Greqia (36,5 %) dhe Kina (62,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-6,7 %), Gjermania (-3,6 %) dhe Maqedonia e Veriut (-8,0 %).

Gjatë këtij katërmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (26,8 %), Greqia (13,3 %) dhe Turqia (6,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-6,4 %), Gjermania (-18,9 %) dhe Kosova (-8,3 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Prill 2019



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 63,3 %, të gjithë tregtisë. Në Prill 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,2 %), Greqia (7,9 %), Kina (7,0 %) dhe Turqia (6,8 %).

Shkëmbimet tregtare, për katërmujorin e parë 2018, me vendet e BE-së zënë 65,6 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Prill 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 60,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,7 %), Greqia (7,2 %), Kina (6,8 %) dhe Gjermania (6,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksperte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	Janar - Prill 17	87	16,4	183	4,2	-96	47,3
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	Janar - Prill 18	101	16,8	199	8,5	-97	51,0
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	-0,2	57	8,4	-30	46,8
	Janar - Prill 19	99	-2,3	205	3,2	-106	48,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Prill 2018	Prill 2019	Jan.- Prill. 2018	Jan.- Prill 2019	Prill 2018	Prill 2019	Jan.- Prill. 2018	Jan.- Prill 2019
Vendet e BE-së	19.490	19.267	79.276	76.512	32.593	33.650	123.769	122.937
Austri	94	119	589	794	664	727	2.057	2.473
Mbretëri e Bashkuar	81	105	239	270	558	386	1.752	1.603
Gjermani	1.143	1.226	4.757	4.598	3.955	3.812	17.054	13.825
Greqi	1.103	1.133	4.464	4.044	4.016	5.481	15.875	17.982
Itali	12.773	12.044	50.515	49.944	15.063	14.060	56.179	52.586
Spanjë	1.622	1.763	8.016	5.985	910	1.653	3.596	3.708
Kroaci	71	111	254	367	467	651	1.741	2.058
Të tjera të BE-së	2.602	2.766	10.442	10.509	6.962	6.881	25.514	28.702
Kinë	403	646	2.804	2.000	3.212	5.233	14.699	18.644
Kosovë	1.819	3.100	5.878	8.937	764	727	2.377	2.180
Maqedonia e Veriut	828	996	2.341	2.813	841	773	2.608	2.682
Rusi	5	-	10	58	740	1.286	3.224	4.062
SHBA	382	356	1.691	1.522	1.022	683	3.302	3.381
Turqi	90	159	444	796	4.594	5.487	16.374	17.361
Ukrainë	15	10	76	88	140	462	680	1.063
Zvicër	979	30	1.744	288	508	1.211	3.648	5.685
Të tjera	2.724	2.103	6.655	5.932	8.132	7.440	27.910	26.928
Gjithsej	26.734	26.668	101.246	98.945	52.546	56.952	198.594	204.924

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Prill 2018	Prill 2019	Jan - Prill. 2018	Jan.- Prill 2019	Prill 2018	Prill 2019	Jan.- Prill. 2018	Jan.- Prill 2019
Gjithsej	26.734	26.668	101.246	98.945	52.546	56.952	198.594	204.924
Ushqime. pije. duhan	2.981	3.489	8.985	10.587	8.966	9.306	33.511	34.039
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	6.228	3.931	19.857	14.847	5.256	6.941	20.954	26.524
Produkte kimike dhe plastike	509	692	1.687	2.290	8.194	7.527	27.689	27.470
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	202	222	932	838	1.849	1.757	6.192	5.867
Prodhime druri dhe letre	716	784	2.863	3.118	2.023	2.007	7.189	7.437
Tekstile dhe këpucë	9.908	10.213	41.442	41.192	7.254	7.347	27.981	27.647
Materiale ndërtimi dhe metale	4.155	4.693	17.374	15.999	6.031	7.739	23.058	25.054
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	1.271	1.853	5.340	7.202	11.067	12.228	44.446	43.580
Te tjera	765	791	2.766	2.874	1.905	2.100	7.573	7.307

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	50.515	49.944	5.878	8.937	8.016	5.985	4.757	4.598
Ushqim. pije duhan	2.616	2.724	692	958	368	473	383	443
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	1.342	1.878	599	2.315	6.631	4.675	869	410
Produkte kimike dhe plastike	480	633	347	555	17	13	9	25
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	730	666	1	3	69	63	3	5
Prodhime druri dhe letre	2.024	2.221	140	253	2	3	46	44
Tekstile dhe këpucë	32.200	32.271	33	24	837	663	2.585	2.381
Materiale ndërtimi dhe metale	6.385	4.891	3.496	4.120	83	92	270	535
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	3.369	3.374	212	219	2	3	399	530
Të tjera	1.368	1.286	356	489	7	1	194	226

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	56.179	52.586	14.699	18.644	16.374	17.361	15.875	17.982
Ushqim. pije duhan	5.792	6.044	167	268	1.895	1.846	5.019	4.908
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	3.739	2.414	2	1	195	276	2.265	4.336
Produkte kimike dhe plastike	5.575	5.804	1.460	1.706	2.424	2.441	2.349	2.578
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	4.817	4.774	233	260	110	84	33	14
Prodhime druri dhe letre	2.286	2.103	294	304	959	894	945	974
Tekstile dhe këpucë	14.153	13.264	3.027	3.275	4.972	5.536	1.264	1.225
Materiale ndërtimi dhe metale	6.855	6.394	1.718	3.026	2.480	3.382	2.626	2.552
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	10.975	10.151	6.401	8.223	2.588	2.294	839	880
Të tjera	1.988	1.637	1.397	1.582	752	609	537	516

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifën doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri